



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.40/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në shtyllë publike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 550 (pesëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 22.09.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën ankesë pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke e bashkëngjitur si dëshmi një fotografi të printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 22.09.2017, në rrugën “Sejdi Sejdiu” në Ferizaj, monitoruesi i tyre ka hasur në një poster të kandidatës për Anëtare të Kuvendit të Komunës në Ferizaj, Saranda Musliu nr.47 nga radhët e subjektit politik LDK, e vendosur në hapësira publike, pra në shtyllë publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Ligji Nr.03/L-073) dhe konsideron se subjekti politik LDK, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatës për Anëtare të Kuvendit të Komunës për Ferizaj, në hapsira publike, pra në shtyllë elektrike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2017, ka theksuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar pasi që duke marrë parasysh që komunat nuk kanë arritur që ta rregullojnë sipas ligjit krijimin e hapësirave të veçanta me qëllim të vendosjes së materialeve me përmbajtje zgjedhore, edhe në rastin konkret vendosja e posterit në një shtyllë publike nuk është e drejtë të trajtohet si shkelje zgjedhore, pasi që shtyllat elektrike zakonisht janë përdorur për vendosjen e njoftimeve të ndryshme në

mungesë të hapësirave publike, prandaj ky veprim nuk mund të vlerësohet si shkelje. Për më tepër ka shtuar se, subjekti politik LDK i ka ndërmarrë masat e duhura dhe ka evituar shkeljen e pretenduar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlersoj se :

Ankesa është e bazuar

Paneli, pasi vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e supozuar , me rastin e vendosjes së posterit të kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj Saranda Musliu nr.47 nga radhët e subjektit politik LDK në shtyllë elektrike, pra në hapsira publike, Paneli nga fotografia e administruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës, e ofruar nga parashtruesi i ankesës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterit i kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik LDK, është i vendosur në shtyllë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.40/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk tejkohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.